

LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-044 PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-044 PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE SHËRBIMIN DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Neni 6 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Neni 6

Emërimi i ambasadorëve dhe shefave të misioneve

6.1. Ambasadorët, Konsujt e Përgjithshëm dhe Konsujt, si dhe shefat e tjerë të misioneve duhet të plotësojnë kërkesat si në vijim:

- a) kanë shtetësi të Kosovës;
- b) kanë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) nuk janë dënuar për kryerje të veprës penale ose nuk janë nën hetime;
- d) nuk janë subjekt i masës disiplinore të largimit nga puna;
- e) janë në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën.

6.2. Ambasadorët, Konsujt e Përgjithshëm, Konsujt, si dhe shefat e tjerë të misioneve duhet të plotësojnë edhe kërkesat si në vijim:

- a) kanë përgatitje të duhur profesionale;
- b) kanë reputacion të lartë;
- c) njohuri të marrëdhënieve ndërkombëtare;
- d) zotërojnë gjuhë të huaj të pranueshme dhe të përshtatshme për punën në shërbimin e jashtëm.

Neni 2

Neni 7 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

7.1 Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret.

7.2. Ministri i Punëve të Jashtme, pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria, ia dërgon emrin e kandidatit për Ambasador ose Shef Misioni, në besim, Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Para se të kërkojë pëlqimin nga Qeveria, Ministria e Punëve të Jashtme sigurohet se kandidati i plotëson kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 6.

7.3. Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës mban seanca të mbyllura dëgjimore për kandidatin e propozuar nga Qeveria, për të verifikuar plotësimin e kriterëve të caktuar në paragrafin 2 të nenit 6. Pas seancës dëgjimore, Komisioni ia raporton rezultatet e dëgjimeve të tij, në besim, Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

7.4. Verifikimi i plotësimit të kriterëve, të caktuar në paragrafin 2, të nenit 6 për kandidatët për Ambasadorë dhe Shefa të Misioneve, të cilët janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës bëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme.

7.5. Raporti i Komisionit është konsultativ dhe nuk e detyron Presidentin e Republikës së Kosovës.

7.6. Presidenti, pas marrjes së raportit Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Republikës së Kosovës, vendos nëse kandidati duhet të emërohet për në shtetin pranues ose organizatën ndërqeveritare ndërkombëtare. Pasi të jetë marrë pëlqimi nga shteti pranues, Presidenti akrediton kandidatin e emëruar.

7.7. Së paku pesëdhjetë përqind (50 %) të emërimeve të Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve duhet të bëhet nga anëtarët në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

7.8. Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm.

7.9. Emërimi i personelit tjetër në Ambasadë ose Misione jashtë bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

7.10. Emërimi i Konsujve të Përgjithshëm bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës. Rekomandimi bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme.

7.11. Emërimi i Konsujve bëhet nga Ministri i Punëve të Jashtëm.

Neni 3 Hyrja në fuqi e Ligjit

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-207
8 korrik 2010**

Shpallur me dekretin Nr. DL-037-2010, datë 28.07.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu.